



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
NJËSIA E HARTIMIT TË DOKUMENTAVE TË TENDERIT

Nr. _____ prot.

Himarë, më ____ . ____ . 2026

PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PR OBJEKTI I PROKURIMIT: “Ndërtimi i ujësjellësit Qeparo”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT : Punime ndërtimi për
ujësjellës 45247130-0**

**FONDI LIMIT: 166,666,667 (Njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë milionë e gjashtëqind e
gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë lekë) pa TVSH .**

**KOHEZGJATJA E KONTRATES/MARREVESHJES KUADER OSE AFATI PER ZBATIMIN E
SAJ : 12 (dymbëdhjetë) muaj kalendarikë.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Himare** , ka hartuar procesverbalin për argumentimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

Sipas parashikimeve ligjore për procedurat Specifikimet Teknike ,Relacione , Projektet , Preventivi etj. dhe llogaritja e Fondit Limit përcillen nga Autoriteti Kontraktor perfituesi cili kërkon realizimin e punimeve.

Perllogaritja e fondit limit dhe specifikimeve teknike është kryer nga inxhinier i licensuar referuar nenit 76 të pikës (a) të VKM-së me nr.285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, që përcakton “çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj”, Inxhinieri është mbështetur në manualin teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre bazuar në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar. - VKM nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve” - Udhëzimi nr.2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar. me qëllim që vlera limit e kontratës, të jetë një vlerë e matshme dhe njëkohësisht e të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Himarë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Sipas kriterëve të përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit pika 1 e kësaj shtojce (Shtojca 7).

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2023, 2024, dhe 2025** lëshuar nga administrata tatimore, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që po prokurohet.

Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.”

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2023, 2024, dhe 2025**, të konfirmuara me vulë pranë autoriteteve përkatëse (Administratës Tatimore), dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të ligjit Nr.10 091, datë 05.03.2009, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit

Shëmin: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma "c" të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku parashikohet se: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit".

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qendrueshëm.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja c" të Ligjit nr. 1009/2009: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".**

2.2.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë shlyer taksat për vitin **2025 dhe 2026** për adresën ku ai ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar, sipas përcaktimeve të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave

vendore”, i ndryshuar, ku nëse kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë vërtetim/e lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e këtyre taksave sipas vetëdeklarimit të kryer në shtojcën 8 të DST-së.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dheneni 40, ne ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe ne ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

- Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **50 %** e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;
ose
- punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për plotësimin e këtyre kritereve Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

a) Në rast se punimet janë kryer me ente publike: Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon:

- i. Kontratën e Sipërmarrjes,
- ii. Situacionin përfundimtar të objektit
- iii. Faturat Tatimore të miratuar sipas legjislacionit tatimor te delaruara ne organet tatimore
- iv. Aktin e Kolaudimit të objektit
- v. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr. 9
- vi. Në rast se kontrata e ngjashme është lidhur nga një bashkim operatorësh ekonomikë duhet të paraqitet edhe kontrata e bashkëpunimit midis tyre.

b) Në rast se punimet janë kryer në sektorin privat: Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon:

- i. Kontratën e Sipërmarrjes,
- ii. Situacionin përfundimtar të objektit
- iii. Faturat Tatimore të miratuar sipas legjislacionit tatimor te delaruara ne organet tatimore
- iv. Aktin e Kolaudimit të objektit
- v. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr. 9

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenin 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri

kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerën 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e ulët monetar. Vlera për punë të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvojë duke patur parashysh objektin dhe vlerën e kontratës.

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garanton autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë se disponojnë liçensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe në liçensë të disponojnë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin liçensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.42, datë 16.01.2008 *“Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”*, i ndryshuar. Liçensa profesionale e operatorit ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

- **Për punimet e përgjithshme të ndërtimit, operatori ekonomik duhet të disponojë kategoritë e mëposhtme në liçensë:**
 - NP-1 C Punime germimi ne toke.
 - NP-4 A Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai
 - NP-7 D Ujesjelles,kanalizime, vepra kullimi dhe vaditje.
 - NP-11 A Ndertime për n/stacionet, kabinat e transformatorëve linja.
 - NP-12 A Punime të inxhinierisë së mjedisit.
- **Për punimet speciale të ndërtimit, operatori ekonomik duhet të disponojë kategoritë e mëposhtme në liçensë:**
 - NS-4 A Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese.
 - NS-9 A Punime strukturore speciale
 - NS-14 A Impiante te brendshme elektrike,telefonike,radiotelefoni TV
 - NS-16 A Nderitim i impjanteve te ujit te pijshme dhe pastrim te tij
 - NS-18 A Punime Topogjeodezike.

* Për Operatorët e huaj të bëhet njehësimi i liçensës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit në plotësimin e liçensave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

* Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, Liçensat profesionale duhet t’i paraqesë operatori ekonomik që ka marrë përsipër punimet për të cilat kërkohet Liçensa Profesionale.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar si dhe Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar. Të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane. Referuar kategorive të kërkuara, AK argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas zërave të preventivit të punimeve.

-Kategoritë janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Përshkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive
NP 1 C	Punime gërmimi ne toke	Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shkarkim ne mjet , Gërmim shkemb i forte me çekiç me ekskavator me zinxhir , Përgatitja e sipërfaqeve të gërmuara (nënbazë / subgrade) , Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 10.0 km	C (51–100 milionë lekë)
NP-4 A	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai.....	Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri , Shtrese stabilizant t=10 cm , Shtrese binderi me granil gur kave,7cm,me makineri , Spraj bituminoz , Mbushje, rafshim,ngjeshje me tokmak elektrik, cdo 30 cm, toke te forte	A (0-20 milionë lekë)
NP-7 D	Ujesjelles,kanalizime, vepra kullimi dhe vaditje	Të gjithë zërat e punimeve të parashikuara në preventiv janë në funksion të ndërtimit të rrjetit të ujësjellësit, duke përfshirë furnizimin me materiale, transportin, montimin, instalimin dhe realizimin e të gjitha punimeve sipas projektit	D (101-200 milionë lekë)
NP-11 A	Ndertime për n/stacionet, kabinat e transformatorëve linja	F.V. Aksesor shtyllor (qafore) linje per terheqje ne dy krah D = 150 mm te galvanizuara , FV Elektrode tokezimi "+" St/Zn 50x50x1500 mm me morsete universale , F.V.Morsete universale per shkeputes tokezimi Ø=(9-16)mm ,F.V Bullon celiku i galvanizuar M12x40 + dado +rondele suste + rondele drejte , F.V. Kapikorde me qaf te gjate Cu/Al DTL 2 x 25 , F.V. Aksesor shtyllor (qafore) abonenti D = 150 mm , F.V.Nyje lidhese te izoluara (konektore)bashkuese S=16-95/16 , FV Shkarkues elektrik 20KV/ 5 kA, FV Siguresa elektrike te TM 20 KV, 4 A , Kontur Tokezimi , Fishek siguresa elektrike 20 KV/ 4 A , Bazament Siguresash te TM 20 KV , FV Transformator 50 KVA, 20/0.4, tipi me vaj , Traversa metalike e tipit PI me dopio izolator te zinguar per TM , Ndares I TM 20 KV, 400 A me doreze Tokezim I ndaresit , Tabela te sigurimit , Kolaudim i rezistences se tokezimit ,Gjenerator diezel me fuqi 10 KW, 0,4 KV , Konstruksione metalike (thika, siguresa, trafo, etj) , Aksesore lidhes dhe sinjalistike per TM (ura te TM, Kapikorda) , Montim dhe Ansamblim I elementeve elektrike , F.V. Shtylla betonarme te centrifuguara 10 ml, 6kN (me makineri)	A (0-20 milionë lekë)

NP-12A	Punime të inxhinierisë së mjedisit.	Punimet per ndertimin e objektit kane impakt mjedisor ne te gjithë zonen perreth saj duke pasur parasysh pozicionimin e saj ne zone e banuar urbane , sasine e madhe te mbetjeve te gjeneruara nga punimet e prishjeve dhe germimeve , për menaxhimin e punime të ujrave të ndotura etj duke ju permbajtur VNM .Bazuar ne ligji nr. 10431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" (i ndryshuar).	A (0-20 milionë lekë)
NS-4A	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese.	Mur me tulla te plota zak, deri 3m, llaç perzier M 25 , Shtresa (mbulesa asfaltike e ngjitur me fibra të përforcuar me fibra, pengesa horizontale e lagështisë në mure me tulla 30 cm mbi tokë) , Hidroizolim me dy shtresa astar me baze cemento. Pergatitur nga dy komponente A+B , Shtrese lluster cemento 1:2 , Mbulesë asfalti (300 g /m2), çatia , Beton i lehtë, pesha specifike: 15 kN / m2, pjerrësi: 2%, trashësi: 30 - 130 mm (çatia) , Dyert (e jashtme, 2100/900 mm, me kornizë dhe materiale fiksuese, setin e mbylljes, varëset, trashësia e tehut të derës: 5 cm me izolim termik, sipërfaqe: e mbrojtur me lyerje) , Ekranet dhe dritat e huazuara (50 x 30 cm, hapja e ventilimit të pusëtës së kontrollit, çelik i galvanizuar, me rrjetë për insekte (madhësi rrjet 1x1 mm), korniza dhe materialet fiksuese) , Dritaret (me dy krahë, përmasat: 1.60 x 1.00 m, përfshirë kornizën dhe materialet e fiksimit, funksionin e kthesës dhe animit, xhamin me dy shtresa dhe kornizën termike) , Suva e zakonshme fasade mur guri ~ 8m , Shtrese me pllaka mermeri, 40x40cm	A (0-20 milionë lekë)
NS-9 A	Punime strukturore speciale	Zëri i preventivit “Strukturë monolite betoni me çakëll C30/37”, i cili do të përdoret në ndërtimin e depove të ujit, klasifikohet si punim strukturor special, për shkak të kërkesave të larta teknike, qëndrueshmërisë strukturore dhe garantimit të hidroizolimit dhe jetëgjatësisë së objektit. Ky punim realizohet në përputhje me projektin, specifikimet teknike dhe standardet përkatëse në fuqi për strukturat hidrike dhe të betonit të armuar	A (0-20 milionë lekë)
NS-14 A	Impiante te brendshme elektrike,telefonike,radiotelefoni TV	Përçues Fleksibël, Ø 25 mm , Përçues Fleksibël,, Ø 25 mm , Kuti me rakorderi, PVC, tipi PT2 Çelësa , Ndriçim, 2 x 36 W, IP 65 , Ndriçim, 2 x 36 W, IP 65 (ndriçim i jashtëm) , Priza, Shuko, 1x16A230V IP-65 , Priza, IP-65 2P - 16 A / 250 V , Priza, IP-65 2P - 16 A / 250 V , F.V Ndriçim, 2 x 36 W, IP 65 , F.V Ndriçim, 2 x 36 W, IP 65 (ndriçim i jashtëm) , V.F Priza dhe çelës dykahësh për montim të jashtëm në mur, IP65, 2P – 16 A / 250 V , Sistem tokëzimi dhe rrufepritës për stacionin e pompimit të ujërave të zeza , Sistemi i tokëzimit të stacionit të pompimit të ujërave të zeza (elektroda tokëzimi, linja e tokëzimit, etj.) ,	A (0-20 milionë lekë)
NS-16 A	Ndertim i impjanteve te ujit te pijshme dhe pastrim te tij	Dhoma e klorinimit përfshin të gjithë sistemin e dozimit të klorit për trajtimin dhe dezinfektimin e ujit të pijshëm, duke garantuar cilësinë dhe sigurinë sanitare të ujit sipas standardeve në fuqi. Punimet përfshijnë furnizimin, instalimin dhe vënien në funksion të pajisjeve të dozimit, depozitimit, tubacioneve lidhëse, elementëve të kontrollit dhe sigurisë, si dhe të gjithë infrastrukturës së nevojshme teknologjike dhe elektrike. Ky zë lidhet drejtpërdrejt me ndërtimin e impjanteve të ujit të pijshëm dhe sistemet e pastrimit/trajtimit të tij.	A (0-20 milionë lekë)
NS 18A	Punime topogjeodezike	Punimet topogjeodezike në kuadër të ndërtimit të ujësjellësit përfshijnë matjet, piketimet dhe kontrollin gjeometrik të të gjithë elementëve të projektit, në përputhje me vizatimet dhe specifikimet teknike. Këto punime përfshijnë piketimin e gjurmës së tubacioneve, matjen e volumeve të germimeve për kanalet e vendosjes së tubacionit, si dhe piketimin dhe kontrollin e punimeve të depove të ujit dhe pusetave b/a, përfshirë themelet, kolonat, soletat dhe muret e objekteve. Gjithashtu përfshihet rilevimi topografik i terrenit ku do të realizohet objekti, matja në planimetri, gjatësi dhe lartësi e të gjitha strukturave, kontrolli i kuotave gjatë zbatimit të punimeve, si dhe matjet për sistemet e jashtme dhe	A (0- 20 milionë lekë)

		elementët ndihmës të infrastrukturës. Këto procese janë të domosdoshme për garantimin e saktësisë së zbatimit të projektit dhe realizimin korrekt të rrjetit të ujësjellësit dhe objekteve shoqëruese.	
--	--	--	--

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatat ISO, si më poshtë:

- Shoqëria duhet të paraqesë Certifikatë të cilësisë së punimeve **ISO 9001 (e vlefshme) ose ekuivalente**. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën ISO ndërkohe që secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt-marrëveshjes).
- Shoqëria duhet të paraqesë Certifikatë **ISO 14001 (e vlefshme) ose ekuivalente**. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën ISO ndërkohë që secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt-marrëveshjes).
- Shoqëria duhet të paraqesë Certifikatë **ISO 45001 (e vlefshme) ose ekuivalente**. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën ISO ndërkohe që secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt-marrëveshjes).
- Shoqëria duhet të paraqesë Certifikatë **ISO 39001 (e vlefshme) ose ekuivalente**. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën ISO ndërkohë që secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt-marrëveshjes).
- Shoqëria duhet të paraqesë Certifikatë **EN ISO 3834-2 (e vlefshme) ose ekuivalente**. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën ISO ndërkohë që secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt-marrëveshjes).

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, Operatori ekonomik do të paraqesë ISO-t në baze të zerave të punimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

Nese certifikatat janë në gjuhë të huaj, ato të paraqiten të perkthyer dhe të noterizuara në gjuhën zyrtare shqipe. Këto certifikata të jenë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatat e mesipërme sipas natyrës së punimeve që do të marrë përsipër të realizojë, referuar kontratës së bashkëpunimit të nënshkruar.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 2.3.11 gërma “a”- “e” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

ISO 9001:2015 / ekuivalente është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe

private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t'i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 / ekuivalente ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001-2018/45001-2023 / ekuivalente është standard ndërkombëtar, i cili parashtrohet kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 ose ISO 45001-2023 ose me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushjen me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

EN-ISO 3834-2:2021/ ekuivalente është standart ndërkombëtar, i cili përcakton kërkesat për sistemin e menaxhimit të cilësisë në Saldim. Çdo Ofertues që merr persiper punime saldimi, duhet të jetë i pajisur me EN-ISO 3834-2:2021 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të jetë në përputhje me sistemin e menaxhimit të cilësisë në Saldim. Duke marrë shkas dhe nga natyra e objektit të prokurimit (strukturat metalike ku ka edhe saldime), me ritjen e cilesise se ndertimit, është e domosdoshme që Ofertuesit të jenë të pajisur me EN-ISO 3834-2:2021/ekuivalente pasi materiali i dobët, i pasaktë dhe kushtet negative të saldimit krijojnë probleme serioze, të kushtueshme të cilat mund të cojnë në carje të nyjeve.

Në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu XI, Neni 88, pika 3, cilësohet se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje”.

Për sa më lart, Njësia e Prokurimit, gjykon se, kjo kërkesë në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik duhet të përmbushet nga Shoqëria e cila referuar Marrëveshjes së Bashkëpunimit ka marrë përsipër të realizojë zerat e parashikuara sipas Preventivit.

AK gjykon se kërkesa për pajisjen e Ofertuesve me Çertifikatat e kërkuara sipas pikës 2.3.3 gërma “a”-“e”, është brenda kuadrit të parashikuar nga legjislacioni për prokurimin publik. Çertifikatat e kërkuara janë në përputhje me objektin e kontratës dhe respektojnë natyrën e punimeve.

- 2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak se **70 (shtatëdhjete) punonjës**, për periudhën **3 (tre)** muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, ku përfshihen edhe Stafii menaxherial i Drejtuesve Teknik. Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të punonjësve në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 8 në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë:

1. Vërtetimi të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme.
2. Listëpagesat e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës dhe pagën minimale të lejuar që duhen për të përmbushur kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje tre mujore nga data e zhvillimit të tenderit, tregojnë besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përqipet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës. *Po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve.* Vendosja e kriterit për një punësim të paktën **70 (shtatëdhjetë) punonjës** duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën e punimeve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Analizat teknike janë bazuar në VKM Nr. 216, datë 13.04.2023 “ Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”. Bazuar në këto elementet e strukture së kostos (material, punëtori, makineri, transport).

(Numri i punonjësve, i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore)

Në mënyrë të përmblodhur numri i fuqisë punëtore që kërkohet për realizimin e punimeve është min **70 (shtatëdhjetë) punonjës**,

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor e mbështetës, punonjësit specialistë dhe certifikimet përkatëse, si më poshtë:

- a) Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë në licencë të shoqërisë e të punësuar në stafin e tij teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë noteriale pune (të

vlefshme), diplomë përkatëse, CV, libreze pune, si dhe të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.6, stafi inxhinierik si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Ndertimi Profili Strukturist
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (një) Inxhinier Elektrik
- 1 (një) Inxhinier Mjedisi
- 1 (një) Inxhinier Gjeolog
- 1 (një) Inxhinier Mekanik
- 1 (një) Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshejder

Disponimi i stafit inxhinierik do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar më lart.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa “c”.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtim, hidroteknik, etj është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtues teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij **drejtues teknik** të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2.3.2, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar si me siper, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

Lidhur me kërkesën që Drejtuesit Teknik të punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohe të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” germa “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKB apo gjykatë. Ndalohe ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar, të cilët në bashkëpunim me njëri

tjetrin ,stafin mbeshtetes si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

- **Inxhinier Ndërtimi profili Strukturist** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve objekt kontrate për të gjithë zërat e punimeve ndërtimore, sipas parashikimeve në projektin konstruktiv.
 - **Inxhinier Hidroteknik** është përgjegjës për ndjekjen dhe zbatimin e saktë të punimeve hidroteknike objekt kontrate, në përputhje me projektin, specifikimet teknike dhe standardet në fuqi. Ai mbikëqyr realizimin e rjetit të ujësjellësit, depove të ujit, pusetave, linjave të transmetimit dhe shpërndarjes, si dhe të gjithë elementëve hidraulikë dhe teknologjikë të sistemit, duke garantuar funksionimin korrekt, cilësinë e punimeve dhe zbatimin sipas kërkesave teknike të projektit.
 - **Inxhinieri Elektrik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve elektrike lidhur me zërat e punimeve të parashikuara në projekt-preventiv.
 - **Inxhinier Mjedisi** është përgjegjës për zgjidhjen e problemeve mjedisore për mbrojtjen e mjedisit lidhur me punimet e parashikuara në projekt-preventiv.
 - **Inxhinier Gjeolog** është përgjegjës për vlerësimin e kushteve gjeologjike të zonës ku do të ndërtohet objekti.
 - **Inxhinieri Mekanik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve mekanike, referuar punimeve të parashikuara në projekt-preventiv.
 - **Inxhinier Topograf/ Gjeodet/Markshajder** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve që përfshin kuota dhe piketime lidhur me punimet e parashikuara në projekt-preventiv.
- b) Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar për kryerjen e punimeve sipas zerave të preventivit të punimeve, si më poshtë:
- **Inxhinier Ndërtimi Profili Strukturist 1 (një)**
 - **Inxhinier Hidroteknik 1 (një)**

Per punojesit e mesiperm duhet te paraqiten:

- Kontratat e punës individuale (të vlefshme).
- Certifikata/diploma për formimin profesional (të vlefshme), të cilat duhet të jenë të lëshuara nga institucione publike/private të licensuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”, i ndryshuar.
- Per punonjesit teknik/ndertimi/topograf diplome të shkollës së mesme profesionale
- Te gjithë punojësit e mësipërm duhet të figurojnë në listepagesat të shoqërisë minimalisht për periudhën 3 muajore.
- Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjesit e mesiperm , emer/mbiemer, profili i punes, numri dhe datë e kontratës individuale të punës, numrin e amazës dhe titullin e kualifikimit për diplomën/certifikatën përkatëse si dhe emrin e institucionit që ka lëshuar dokumentin për specialistet e kualifikuar me sipër.

Diplomat/certifikatat e paraqitura nga organizma të cilat nuk janë të licensuara sipas legjislacionit në fuqi do të konsiderohen si dokumenta të rreme të cilat përbëjnë shkak për skualifikim dhe/ose përjashtimin nga pjesëmarrja në prokurimet publike.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8. Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas deklarata B.

Shënim: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor do i kërkojë ofertuesit i kualifikuar i pari dorëzimin e dokumentacionit të mëposhtëm:

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për disponimin e stafit teknik, konkretisht:

- **1 (një) Inxhinierë Ndërtimi me profil Strukturist**
- **1 (një) Inxhinier Hidroteknik**

është vendosur në përputhje me përcaktimet e Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Neni 77, pika 4, si dhe VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa “c”. Kjo kërkesë lidhet drejtpërdrejt me natyrën, kompleksitetin teknik, shtrirjen gjeografike dhe volumet e punimeve të parashikuara në projekt dhe preventiv. Projekti objekt prokurimi nuk zhvillohet në një kantier të vetëm pune, por përfshin realizimin e punimeve në disa fronte dhe zona të ndryshme pune njëkohësisht, si rrjete ujësjellësi, depo uji, puseta b/a, linja transmetimi dhe shpërndarjeje, sistemime të jashtme, si dhe elementë strukturorë të objekteve hidrike.

Për këtë arsye, prania e vetëm një Inxhinieri Ndërtimi me profil Strukturist nuk do të ishte e mjaftueshme për të garantuar ndjekjen e vazhdueshme, kontrollin teknik dhe mbikëqyrjen cilësore të të gjitha proceseve të punës në disa kantierë paralelë. Punimet strukturore të parashikuara në projekt, si themelet, kolonat, muret mbajtëse, soletat, strukturat monolite të betonit të armuar, depot e ujit dhe puseta b/a, kërkojnë kontroll të vazhdueshëm teknik në faza të ndryshme zbatimi, duke përfshirë kontrollin e armaturës, kallëpeve, betonimeve, kuotave dhe parametrave konstruktivë sipas projektit të zbatimit.

Në këto kushte, kërkesa për **1 (një) Inxhinierë Ndërtimi me profil Strukturist** është e domosdoshme për të siguruar:

- mbikëqyrje të vazhdueshme në disa fronte pune njëkohësisht;
- koordinim teknik të proceseve ndërtimore;
- kontroll cilësor të punimeve strukturore;
- respektimin e afateve të zbatimit;
- shmangien e problematikave teknike gjatë realizimit të objektit.

Gjithashtu, kërkesa për **1 (një) Inxhinier Hidroteknik** lidhet drejtpërdrejt me natyrën e projektit, i cili përfshin punime specifike hidroteknike dhe instalime të rrjetit të ujësjellësit. Inxhinieri Hidroteknik është i nevojshëm për ndjekjen e zbatimit të linjave të transmetimit dhe shpërndarjes, kontrollin e parametrave hidraulikë, vendosjen e tubacioneve, elementëve teknologjikë, pusetave, depove të ujit dhe funksionimin korrekt të sistemit në tërësi.

AK vlerëson se kërkesa për këtë staf nuk është kufizuese, por proporcionalisht e lidhur me objektin e kontratës, volumet e punimeve dhe nevojën reale për garantimin e zbatimit cilësor dhe në kohë të projektit. Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë se disponojnë kapacitetet e nevojshme teknike, profesionale dhe organizative për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi.

- c) 1 (një) punonjes i pajisur me çertifikate “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq ose shoqeri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", VKM-se Nr. 312, dt 05.05.2010 "Për sigurinë në kantier", VKM-së Nr.108, dt 09.02.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, pika 1.a dhe 1.b, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certificate, Libreze pune si dhe të figurojnë në listpagesat e E-Sig minimalisht për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave.

Argumentimi : Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesa e mësipërme mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”. Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

–“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” rekomandohet të jete në kantier për trajnimin e punonjesve të kantierit për minimizimin e aksidenteve në punë.

d) 1 (një) person, i certifikuar si “*Specialist për testimin e performances së materialeve/produkteve të ndërtimit /inxhinier materiale*”.

Për stafin e mësipërm Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve objekt kontrate, Diplomë, Librezë pune dhe CV.

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa “c”.

Kriteri për stafin e mësipërm, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtim, hidroteknik, etj është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar jo domosdoshmërisht të përfshirë në liçensën e shoqërisë është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar si me siper, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

Specialist Për Testimin e Performances së Materialeve/Produkteve të Ndërtimit /Inxhinier Materiale është përgjegjës për vlerësimin dhe testimin e materialeve dhe produkteve që përdoren në industrinë e ndërtimit për t’u siguruar që ato përmbushin standardet e kërkuara për sigurinë dhe cilësinë. Ky lloj specialisti duhet të ketë njohuri të thella në lidhje me metodat e testimit, standardet kombëtare dhe ndërkombëtare, dhe materialet që përdoren në ndërtim.

- e) Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të ken pjesë të stafit të tij ose si staf mbështetës (me kontratë pune/kontratë bashkëpunimi) si më poshtë:
- Minimumi 1 (një) punonjës Saldator, të jenë të pajisur dhe certifikuar me: **SSH/EN ISO 9606-1**, për punimet e saldimit. Për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik do të paraqes certifikatat e lëshuara nga institucione të akredituara përkatëse ose ekuivalentin e tyre dhe kontratat e punës.
 - Minimumi 2 (dy) punonjës Saldimi me elektrofuzion , të jenë të pajisur dhe certifikuar me: **SSH/EN 13067:2020** , për punimet e saldimit të tubacioneve. Për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik do të paraqes certifikatat e lëshuara nga institucione të akredituara përkatëse ose ekuivalentin e tyre dhe kontratat e punës.

Për stafin e mësipërm Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve objekt kontratë, Diplomë/Çertifikatë.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për stafin teknik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa “c”.

Kriteri për stafin e mësipërm lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët dhe punonjësit teknikë në objekt është diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë standardeve dhe me cilësi të dobët të punimeve.

Numri i stafit kryesor teknik, si dhe i punonjësve saldatorë, është përcaktuar duke marrë në konsideratë natyrën teknike të kontratës, me qëllim garantimin e mbarëvajtjes dhe zbatimit sa më cilësor të punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike dhe profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për realizimin e kontratës objekt prokurimi.

2 (dy) punonjës saldatorë

Kërkesa për disponimin e 2 (dy) punonjësve saldatorë të certifikuar sipas standardit SSH/EN ISO 9606-1 “Prova kualifikimi për saldatorët – Saldimi me shkrije” është vendosur me qëllim garantimin e cilësisë dhe sigurisë së punimeve të saldimit, të cilat janë pjesë integrale e zërave të preventivit, konkretisht:

- Në zërin e punimeve “F.V. Konstrukione metalike të thjeshta” dhe “Tuba çeliku për ujësjellës”, përfshihet vendosja e tubacioneve metalike, ku lidhja e tyre realizohet nëpërmjet saldimit. Cilësia e këtyre saldimeve është kritike, pasi sistemi do të punojë nën presion dhe kërkohet shmangia e rrjedhjeve si dhe garantimi i jetëgjatësisë së sistemit.
- Në zërat e veprave të artit, si kalimet e tubacioneve në përrën timer nëpërmjet tubave të çelikut, kërkohen elementë ndihmës metalikë, si korniza, mbajtëse dhe përforcime, të cilat realizohen ose fiksohen nëpërmjet saldimit gjatë fazës së zbatimit.

Në këtë kontekst, kërkesa për 2 (dy) saldatorë të certifikuar sipas standardit SSH/EN ISO 9606-1 garanton që punimet e saldimit të realizohen sipas standardeve të njohura ndërkombëtare, të minimizohen defektet në lidhjet metalike, të cilat mund të sjellin probleme funksionale, si rrjedhje në tubacione, apo rrezik për sigurinë e objektit, si dhe të sigurohet qëndrueshmëria dhe jetëgjatësia e elementëve metalikë të përfshirë në projekt.

2 (dy) punonjës për saldim me elektrofuzion

Kërkesa për disponimin e 2 (dy) punonjësve të certifikuar për saldim me elektrofuzion sipas standardit SSH/EN 13067:2020 është vendosur me qëllim garantimin e cilësisë dhe sigurisë së punimeve të saldimit të materialeve plastike termoplastike, të cilat janë pjesë integrale e zërave të preventivit, konkretisht:

- Në zërin e punimeve “PE 100-RC, SDR 17, OD”, përfshihet vendosja e tubacioneve plastike PE, ku lidhja e tyre realizohet nëpërmjet saldimit me elektrofuzion. Cilësia e këtyre saldimeve është thelbësore, pasi sistemi do të punojë nën presion dhe kërkohet shmangia e rrjedhjeve si dhe garantimi i jetëgjatësisë së rrjetit.
- Në zërat e montimit të rakorderive të depos dhe elementëve lidhës të rrjetit, kërkohet përdorimi i rakorderive dhe manikotave me elektrofuzion, të cilat realizohen nëpërmjet proceseve të specializuara të saldimit gjatë fazës së zbatimit.

Në këtë kontekst, kërkesa për 2 (dy) punonjës të certifikuar sipas standardit SSH/EN 13067:2020 garanton që punimet e saldimit me elektrofuzion të realizohen sipas standardeve të njohura ndërkombëtare, të minimizohen defektet në lidhjet e tubacioneve plastike, të cilat mund të sjellin probleme funksionale, si rrjedhje në rrjet, apo dëmtime të sistemit gjatë funksionimit, si dhe të sigurohet qëndrueshmëria dhe jetëgjatësia e tubacioneve dhe elementëve të përfshirë në projekt.

Për rrjedhojë, kjo kërkesë është në përpjesëtim të drejtë me natyrën, kompleksitetin dhe volumet e zërave të preventivit dhe shërben drejtpërdrejt për garantimin e cilësisë së punimeve dhe sigurisë gjatë zbatimit të objektit.

- f) Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklarate (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë, dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, ku në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për drejtuesin teknik të deklaruar, duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Librezë pune (përkatëse)
 - CV përkatëse
 - Kontratë noteriale pune e vlefshme (përkatëse)
 - Diplomë
 - Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik në bashkim, duhet të përcaktojë me anë të një deklarate, Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varësi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë përsipër sipas përqindjes së bashkëpunimit.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Argumentimi: Së pari, kjo kërkesë mbështetet ne Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Së dyti, duke qenë se objekt prokurimi është kontratë pune sqarojmë se detyrimin për prezencën e Drejtuesit Teknik gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt e përcakton qartazi Udhëzimi Nr.2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, konkretisht pika 1.2 ku citohet se: “drejtuesit ligjore dhe teknik të sipërmarrësit janë përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi” si dhe pikës 2.1 ku citohet se “drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejtë nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit.

Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera, mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik

i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKR apo gjykatë. Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga kontrata e punës objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dipsozitive ligjore në fuqi.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, se ka pjesë të stafit të punësuar:

- Teknik Ndërtimi	Minimumi 2 (dy) punonjës
- Teknik Hidroteknik	Minimumi 1 (një) punonjës
- Hidraulik	Minimumi 3 (tre) punonjës
- Specialist për montimin e tubave	Minimumi 10 (dhjetë) punonjës
- Hekurkthyes	Minimumi 5 (pesë) punonjës
- Karpentier	Minimumi 5 (pesë) punonjës
- Betonues	Minimumi 5 (pesë) punonjës
- Punonjes i izolimeve (Hidroizolues)	Minimumi 3 (tre) punonjës
- Murator	Minimumi 1 (një) punonjës
- Suvatues	Minimumi 2 (dy) punonjës
- Punëtores Asfalti	Minimumi 4 (katër) punonjës
- Eskavatoriste	Minimumi 3 (tre) punonjës
- Automakinista	Minimumi 3 (tre) punonjës
- Buldozerista	Minimumi 3 (tre) punonjës
- Shofer	Minimumi 5 (pesë) punonjës

,të cilët duhet të figurojnë në listëpagesa të shoqërisë të punësuar për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.6 në rastin kur mjetet/ makineritë e deklaruara janë në pronësi të operatorit ekonomik ofertues, në të kundërt kur mjetet/ makineritë disponohen me qera, ky staf i kërkuar mund të jetë i kontraktuar, **dhe në çdo rast, në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për secilin të paraqiten:**

Per punojesit e mesiperm duhet te paraqiten:

- Kontratat e punës individuale të vlefshme.
- (Dëshmi te Aftësisë Profesionale), që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe tokë, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin Nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës dhe referuar Kodit Rrugor, e cila duhet të perkojë me kërkesat e profilin të deklaruar per cdo punojes.
- Të figurojnë në listpagesat e E-Sig minimalisht për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave, ku punojësit e mësipër duhet të figurojnë te rregjistruar sipas legjislacionit ne fuqi.
- Gjate fazes se ofertimit në plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, pika B. Deklarata -“Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”, operatorët ekonomik per punonjesit eskavatoriste, automakinist, buldozerist, duhet të deklarojnë: emer/mbiemer, profilin e punes, daten e kontrates se punes, numrin e deshmise së aftësisë profesionale dhe daten e vlefshmerise se saj.

Kur mjetet janë marrë me qira nga persona fizik, të cilat janë në pronësi të këtyre të fundit, atehere eskavatorist / automakinistet, dhe shoferet nuk ka nevojë që të figurojnë në listëpagesat përkatëse të O.E. ofertues.

Ne rastin e bashkimit të operatoreve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë punojesit e mesiperm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

AK rezervon të drejtën e verifikimit të deklarimeve për punojesit e mesiperm, çdo informacion i rreme apo i devijuar nga kërkesat e mesiperme do të jetë kusht për skualifikimin e ofertës.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç”. Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punës që do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të përcaktuara në specifikimet teknike. Zbatimi i punimeve që përfshin projektin duhet të kryhet nga fuqi punëtore e kualifikuar për secilën tipologji punimesh. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/ certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”. Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale ofrohen nga institucione të licencuara nga Ministria përkatëse nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional. Certifikatat e këtyre specialisteve duhet të jenë të regjistruara në “rregjistrat profesionale” të AKAFP-se. Përcaktimi i numrit të punonjësve dhe profesionet është bazuar mbi zërat dhe volumet e punës si dhe afateve për përfundimin e punimeve, në mbështetje të të cilave janë bazuar në VKM nr. 216, datë 13.4.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”. Bazuar në kriter elementet e strukturës së kostos (material, punëtor, makineri, transport). Numri i punonjësve, dhe profesionet që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore.

Teknik Ndërtimi : Kërkesa për minimumi 2 (dy) Teknikë Ndërtimi është e nevojshme për ndjekjen teknike dhe organizimin e punimeve të ndërtimit që do të realizohen në objekt, përfshirë punimet e gërmimit, ndërtimin e pusetave, depove të ujit, strukturave prej betoni të armuar, muraturave, sistemimeve dhe punimeve të tjera ndërtimore. Duke qenë se punimet zhvillohen në disa fronte pune, kërkohet prania e stafit teknik për kontrollin e zbatimit të punimeve sipas projektit, kuotave, specifikimeve teknike dhe preventivit, si dhe për koordinimin e fuqisë punëtore në kantier.

Teknik Hidroteknik :Tekniku Hidroteknik nevojitet për ndjekjen dhe zbatimin e punimeve që lidhen drejtpërdrejt me rrjetin e ujësjellësit, tubacionet, rakorderitë, pusetat, depot e ujit dhe pajisjet hidraulike. Ai duhet të asistojë në kontrollin e kuotave, pjerrësive, lidhjeve, montimit të tubacioneve dhe elementëve të rrjetit, duke siguruar realizimin e tyre në përputhje me projektin hidroteknik dhe specifikimet teknike.

Hidraulik : Hidraulikët janë të nevojshëm për realizimin e lidhjeve hidraulike të rrjetit, montimin e rakorderive, valvulave, saraçineskave dhe elementëve të tjerë të sistemit të furnizimit me ujë. Gjithashtu, ata do të angazhohen në realizimin e lidhjeve ndërmjet tubacioneve, pusetave dhe pajisjeve hidraulike, si dhe në ndërhyrjet e nevojshme gjatë provave dhe vënies në funksion të rrjetit.

Specialist për montimin e tubave: Specialistët për montimin e tubave përbëjnë një nga kategoritë kryesore të fuqisë punëtore për këtë objekt, pasi pjesa kryesore e punimeve lidhet me ndërtimin e rrjetit të ujësjellësit. Ata nevojiten për transportimin dhe pozicionimin e tubave në kanal, bashkimin e tyre, montimin e rakorderive dhe elementëve lidhës, kontrollin e aksit dhe kuotave të tubacionit, si dhe realizimin korrekt të nyjeve të rrjetit. Numri prej 10 punonjësish argumentohet nga gjatësia dhe volumi i rrjetit dhe nga nevoja për të punuar paralelisht në disa fronte pune.

Hekurkthyes : Hekurkthyesit nevojiten për përgatitjen, prerjen, kthimin, lidhjen dhe montimin e armaturës së çelikut për strukturat prej betoni të armuar, përfshirë depot e ujit, pusetat, themelet, muret, kolonat dhe soletat. Punimet betonarme kërkojnë përgatitje të saktë të armaturës sipas projektit konstruktiv, për këtë arsye disponimi i kësaj kategorie specialistësh është i domosdoshëm.

Karpentier: Karpentierët janë të nevojshëm për realizimin dhe montimin e kallëpeve për elementët betonarme të objektit, si themelet, muret, kolonat, trarët, soletat, pusetat dhe depot e ujit. Ata do të kryejnë gjithashtu çmontimin dhe ripërdorimin e kallëpeve në fazat e ndryshme të betonimit. Numri i kërkuar lidhet me volumin dhe shumëllojshmërinë e strukturave betonarme që do të realizohen.

Betonues : Betonuesit nevojiten për realizimin e punimeve të betonimit të strukturave të parashikuara në projekt. Detyrat e tyre përfshijnë hedhjen, shpërndarjen, vibrimin, nivelimin dhe trajtimin e betonit për themele, mure, soleta, puseta dhe depo uji. Për shkak të kërkesave të veçanta për cilësinë dhe qëndrueshmërinë e strukturave hidrike, procesi i betonimit kërkon punonjës me eksperiencë specifike.

Punonjës i izolimeve (Hidroizolues): Hidroizoluesit nevojiten për realizimin e hidroizolimit të strukturave që janë në kontakt të vazhdueshëm me ujin ose lagështinë, veçanërisht depot e ujit, pusetat dhe elementët e tjerë betonarme të sistemit. Punimet kërkojnë aplikim korrekt të materialeve hidroizoluese dhe trajtim të nyjeve konstruktive për të garantuar papërshkueshmërinë dhe jetëgjatësinë e strukturave.

Murator: Muratori nevojitet për realizimin e punimeve të muraturës të parashikuara në objekt, duke përfshirë mure ndarëse, mure teknike, riparime dhe elementë të ndryshëm murature në objektet ndihmëse të ujësjellësit. Ai do të angazhohet gjithashtu në punime plotësuese që lidhen me pusetat, dhomat teknike dhe strukturat shoqëruese.

Suvatues : Suvatuesit nevojiten për realizimin e punimeve të suvatimit dhe rifiniturës së mureve të objekteve të parashikuara në projekt, si depot, dhomat teknike dhe objektet ndihmëse. Këto punime shërbejnë për mbrojtjen e sipërfaqeve, përgatitjen e tyre për shtresat përfundimtare dhe garantimin e cilësisë së rifiniturave.

Punëtorë Asfalti : Punëtorët e asfaltit nevojiten për rikthimin në gjendjen përfundimtare të segmenteve rrugore të prekura nga hapja e kanaleve të tubacioneve, si dhe për realizimin e shtresave bituminoze të parashikuara në preventiv. Punimet përfshijnë përgatitjen e sipërfaqes, shpërndarjen dhe sistemin e asfaltit, koordinimin me makineritë e asfaltimit dhe përfundimin e shtresave sipas trashësive dhe parametrave të projektit. Në preventiv janë parashikuar edhe shtresë stabilizanti, binderi dhe spraj bituminoz.

Eskavatoristë : Eskavatoristët janë të nevojshëm për realizimin e gërmimeve të kanaleve të tubacioneve, gërmimeve për pusetat, depot e ujit, themelet dhe strukturat e tjera. Duke qenë se punimet përfshijnë si gërmime në tokë të zakonshme, ashtu edhe punime në terrene më të forta dhe me shkëmb, kërkohet përdorimi intensiv i eskavatorëve në disa fronte pune. Dokumenti parashikon shprehimisht gërmime me ekskavator dhe gërmime shkëmbi me çekiç të montuar në ekskavator.

Automakinistë: Automakinistët nevojiten për drejtimin dhe përdorimin e makinerive të ndryshme të kantierit që do të angazhohen gjatë realizimit të kontratës, përfshirë makineritë për ngarkim, transport të brendshëm, sistemim, ngjeshje dhe procese të tjera mekanike. Prania e personelit të kualifikuar për përdorimin e makinerive është e domosdoshme për realizimin e punimeve në mënyrë të sigurt, të saktë dhe në përputhje me grafikun e punimeve.

Buldozeristë: Buldozeristët nevojiten për sistemin e terrenit, shpërndarjen dhe nivelimin e materialeve, hapjen dhe sistemin e fronteve të punës, përgatitjen e bazamenteve dhe rikthimin e terrenit pas përfundimit të punimeve. Duke qenë se objekti përfshin punime lineare të ujësjellësit dhe ndërhyrje në zona të ndryshme, përdorimi i buldozerëve është i nevojshëm për menaxhimin efikas të volumeve të dheut dhe materialeve.

Shofer: Shoferët nevojiten për transportin e materialeve të ndërtimit, tubacioneve, inerteve, dheut të gërmuar, materialeve për mbushje, betonit dhe pajisjeve të tjera të nevojshme për realizimin e kontratës. Gjithashtu, ata do të realizojnë largimin e materialeve të tepërta nga kantieri dhe furnizimin e vazhdueshëm të fronteve të punës. Duke qenë se në preventiv parashikohen transporte të materialeve dhe dheut deri në distanca të caktuara, disponimi i shoferëve është drejtpërdrejt i lidhur me zbatimin e punimeve.

Në përfundim, kërkesa për kategoritë dhe numrin minimal të punonjësve të mësipërm është përcaktuar në funksion të natyrës, volumit dhe kompleksitetit të punimeve objekt kontrate, si dhe të nevojës për realizimin paralel të disa proceseve dhe fronteve të punës. Disponimi i këtij personeli synon të garantojë realizimin e punimeve sipas projektit, specifikimeve teknike, grafikut të punimeve dhe kushteve të sigurisë dhe cilësisë.

2.3.7 (Makineri, Pajisje)

a) **Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë,** automjetet, makineritë dhe pajisjet (**sipas tabelës**) të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qira të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës;

Nr	Emri i mjetit	Njesia	Sasia/cope	Statusi
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës jo më pak se 20 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
2	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 15-20 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
3	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 3.5 - 5 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera

4	Kamion me vinc	copë	1	Në pronësi ose me qera
5	Damper me goma (MT) me kapacitet mbajtës 1 - 4 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
6	Autobetoniere me goma (MT) me kapacitet 2.5 m ³ - 3 m ³	copë	1	Në pronësi ose me qera
7	Autobetoniere me goma (MT) me kapacitet 8 m ³ - 12 m ³	copë	1	Në pronësi ose me qera
8	Pompe betoni / Autopompe betoni	copë	1	Në pronësi ose me qera
9	Vibrator betoni	copë	2	Në pronësi ose me qera
10	Armatura	m2	300	Në pronësi ose me qera
11	Skela	m2	300	Në pronësi ose me qera
12	Eskavator me goma (MT)	copë	1	Në pronësi ose me qera
13	Fadromë me goma (MT)	copë	1	Në pronësi ose me qera
14	Minifadrome /Bobcat me goma (MT)	copë	1	Në pronësi ose me qera
15	Eskavator me zinxhir i pajisur me çekic hidraulik për thyerje	copë	1	Në pronësi ose me qera
16	Rul Gome - hekur 6 - 8 ton	cope	1	Në pronësi ose me qera
17	Rul hekur-hekur 6-8 ton	cope	1	Në pronësi ose me qera
18	Autobot uji	cope	1	Në pronësi ose me qera
19	Mikser rrotullues per nivelimin dhe perforcimin shtresave rrugore	cope	1	Në pronësi ose me qera
20	Asfaltoshtruese	cope	1	Në pronësi ose me qera
21	Autobitumatrice	cope	1	Në pronësi ose me qera
22	Gjenerator / Motogjenerator	cope	1	Në pronësi ose me qera
23	Elektrosaldatrice/Motosaldatrice/Saldatrice	cope	1	Në pronësi ose me qera
24	Pajisje elektrofuzioni për saldimin e tubave prej polietileni (PE)	cope	2	Në pronësi ose me qera
25	Pompë presioni për testim hidraulik të linjave të ujësllësit dhe aparat digjital për testimin e presionit	cope	1	Në pronësi ose me qera
26	Pajisje për largimin e ujerave nëntoksore me sistem gjilpërthithëse (Sistemi Well Point i pajisur me pompë thithëse, age, kolektor dhe aksesori bashkues) thithëse + tuba	cope	1	Në pronësi ose me qera
27	Trencher per hapje kanali që montohet ne eskavator	copë	1	Në pronësi ose me qera
28	Aparaturë për saldimin me Butt Fusion të tubave prej polietileni (PE), me kontroll të parametrave të saldimit	cope	2	Në pronësi ose me qera
29	Pajisje gjeodezike GPS	cope	1	Në pronësi ose me qera
30	Fabrike Betoni, pajisur me leje mjedisore nga QKL	cope	1	Pronësi /me qera/Kontrate furnizimi
31	Fabrike Asfaltobetoni e pajisur me QKL	cope	1	Pronësi /me qera/Kontrate furnizimi

32	Nyje prodhim Inertesh	cope	1	Pronësi /me qera/Kontrate furnizimi
----	-----------------------	------	---	-------------------------------------

b) Gjithashtu në zbatim të VKM-së Nr.312, datë 05.05.2010, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë mjete dhe pajisje mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit, si më poshtë:

- Kokore – *jo më pak se 60 copë*
- Jelek për kantier fosforoshent - *jo më pak se 60 copë*
- Komplet i ndihmës së shpejtë – *jo më pak se 6 copë*
- Fikëse zjarri të lëvizshme – *jo më pak se 6 copë*
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt – *jo më pak se 15 copë*

□ **Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të mjeteve/ makinerive dhe pajisjeve të kërkuara më lart, në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 8 në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqiten:**

- 1- Për mjetet me goma që shënohen në rregjistra publike duhet të paraqitet dokument që vërteton Rregjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), Çertifikatën e Kontrollit Teknik (*të vlefshme*), Siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), Taksat e paguara, Leje e transportit (*vetëm për kamionët dhe kamionçinat*) dhe foto e dukshme të mjetit.
- 2- Për mjetet e siguruara me qira , të paraqitet kontrata noteriale e lidhur e qerese, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt e këtij prokurimi, shoqëruar me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar plus dokumentat që vërteton Rregjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), Çertifikatën e Kontrollit Teknik (*të vlefshme*), Siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), Taksat e paguara, Leje e transportit (*vetëm për kamionët dhe kamionçinat*) dhe Foto e dukshme të mjetit.
- 3- Për paisjet/ makineritë në pronësi të shoqërohen me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar (*kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi*) dhe Foto e dukshme të pajisjes/ makinerisë (*të paktën 1*).

Argumentimi:

1. Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës jo më pak se 20 ton – 1 copë

Kamioni vetëshkarkues me kapacitet jo më pak se 20 ton është i nevojshëm për transportin e volumeve të mëdha të dheut të dalë nga gërmimet, materialeve inerte, çakëllit, stabilizantit dhe materialeve të tjera të nevojshme për mbushjet dhe sistemit. Kapaciteti i lartë i ngarkesës mundëson transport më efikas dhe redukton numrin e cikleve të transportit gjatë realizimit të punimeve.

2. Kamion vetëshkarkues me kapacitet 15–20 ton – 1 copë

Ky mjet nevojitet për transportimin e materialeve të gërmuara dhe materialeve të ndërtimit në segmentet ku kushtet e aksesit ose volumet e punës nuk kërkojnë përdorimin e kamionit me kapacitet më të madh. Ai mundëson zhvillimin paralel të transportit në fronte të ndryshme të punës.

3. Kamion vetëshkarkues me kapacitet 3.5–5 ton – 1 copë

Kamioni me kapacitet më të vogël është i nevojshëm për transportimin e materialeve në zona me akses të kufizuar, rrugë të ngushta dhe segmente ku mjetet e tonazhit të madh nuk mund të operojnë. Ai përdoret edhe për furnizime të vogla dhe transport të materialeve ndihmëse brenda kantierit.

4. Kamion me vinç – 1 copë

Kamioni me vinç nevojitet për transportimin, ngritjen dhe pozicionimin e tubacioneve, pajisjeve hidraulike, rakorderive, elementëve metalikë, pajisjeve teknologjike dhe materialeve të tjera me peshë të konsiderueshme. Përdorimi i tij garanton manipulim të sigurt të elementëve gjatë ngarkim-shkarkimit dhe montimit.

5. Damper me goma, kapacitet 1–4 ton – 1 copë

Damperi nevojitet për transportin e dheut, inerteve dhe materialeve brenda kantierit, veçanërisht në terrene të ngushta ose të vështira ku kamionët e zakonshëm nuk mund të operojnë. Ai është i përshtatshëm për furnizimin e fronteve të punës përgjatë gjurmës së tubacionit.

6. Autobetoniere me goma, kapacitet 2.5–3 m³ – 1 copë

Autobetonierja me kapacitet të vogël nevojitet për furnizimin me beton të pusetave, themeleve dhe strukturave të tjera në zona ku aksesit për autobetonieret e mëdha është i kufizuar. Dimensionet dhe manovrueshmëria e saj e bëjnë të përshtatshme për punime të shpërndara përgjatë rrjetit.

7. Autobetoniere me kapacitet 8–12 m³ – 1 copë

Autobetonierja me kapacitet të madh nevojitet për transportimin e betonit të freskët për strukturat betonarme me volume të konsiderueshme, veçanërisht depot e ujit, themelet, muret dhe soletat. Ajo mundëson furnizimin e vazhdueshëm gjatë proceseve të betonimit.

8. Pompë betoni / Autopompë betoni – 1 copë

Pompa e betonit nevojitet për hedhjen e betonit në elemente ku shkarkimi direkt nga autobetonierja është i pamundur ose teknikisht i papërshtatshëm, si mure, soleta, depo uji dhe struktura me lartësi apo akses të kufizuar. Përdorimi i saj siguron vazhdimësi dhe shpërndarje uniforme të betonit.

9. Vibrator betoni – 2 copë

Vibratorët e betonit janë të nevojshëm për ngjeshjen e betonit të freskët, eliminimin e boshllëqeve dhe ajrit të mbetur në masën e betonit dhe garantimin e homogjenitetit të strukturave. Kjo ka rëndësi të veçantë për depot dhe strukturat hidrike ku kërkohet rezistencë dhe papërshkueshmëri e lartë.

10. Armatura kallëpimi – 300 m²

Armaturat e kallëpimit janë të nevojshme për realizimin e elementëve prej betoni të armuar, përfshirë themelet, muret, kolonat, soletat, pusetat dhe depot e ujit. Sipërfaqja e kërkuar mundëson organizimin paralel të proceseve të betonimit dhe respektimin e grafikut të punimeve.

11. Skela – 300 m²

Skelat nevojiten për realizimin e sigurt të punimeve në lartësi, punimeve të betonarmese, muraturës, suvatimit, hidroizolimit dhe montimeve në strukturat e objektit. Ato sigurojnë akses të kontrolluar dhe kushte të përshtatshme sigurie për punonjësit.

12. Eskavator me goma – 1 copë

Eskavatori me goma nevojitet për gërmimin e kanaleve të tubacioneve, hapjen e pusetave dhe themeleve, ngarkimin e materialeve dhe sistemimin e terrenit. Për shkak të lëvizshmërisë së tij, është veçanërisht i përshtatshëm për punime lineare përgjatë rrugëve ekzistuese.

13. Fadromë me goma – 1 copë

Fadroma nevojitet për ngarkimin e materialeve të gërmuara në kamionë, shpërndarjen e materialeve inerte, sistemimin dhe nivelimin e terrenit, si dhe furnizimin e fronteve të punës me materiale mbushëse.

14. Minifadromë / Bobcat me goma – 1 copë

Minifadroma është e nevojshme për punimet në hapësira të kufizuara, sistemimin e materialeve dhe pastrimin e kantierit në zona ku përdorimi i fadromave të mëdha është i pamundur. Ajo është veçanërisht e përshtatshme për punimet pranë pusetave dhe në zona të banuara.

15. Eskavator me zinxhir i pajisur me çekiç hidraulik – 1 copë

Ky mjet nevojitet për gërmimet në terrene të forta dhe shkëmbore gjatë hapjes së kanaleve dhe themeleve. Vetë preventivi parashikon gërmim shkëmbi të fortë me çekiç të montuar në ekskavator, ndaj kërkesa lidhet drejtpërdrejt me procesin teknologjik të punimeve.

16. Rul gomë-hekur 6–8 ton – 1 copë

Ruli gomë-hekur nevojitet për ngjeshjen e shtresave të mbushjes, stabilizantit dhe shtresave rrugore pas mbylljes së kanaleve. Kombinimi i gomës dhe cilindrit metalik mundëson ngjeshje të njëtrajtshme të materialeve.

17. Rul hekur-hekur 6–8 ton – 1 copë

Ruli me cilindra metalikë nevojitet për ngjeshjen përfundimtare të shtresave të bazës dhe shtresave asfaltike, duke garantuar dendësinë dhe rrafshësinë e kërkuar të sipërfaqeve rrugore.

18. Autobot uji – 1 copë

Autoboti i ujit nevojitet për lagështimin e materialeve gjatë procesit të ngjeshjes, kontrollin e pluhurit në kantier dhe furnizimin me ujë për procese ndërtimore. Lagështia optimale e materialit është element i rëndësishëm për arritjen e shkallës së kërkuar të ngjeshjes.

19. Mikser rrotullues për nivelimin dhe përforcimin e shtresave rrugore – 1 copë

Pajisja nevojitet për përzierjen, homogjenizimin dhe përgatitjen e shtresave të bazës dhe nënbazës rrugore, veçanërisht në zonat ku rruga ndërhyhet për hapjen e kanaleve dhe duhet të rikthehet në gjendjen e projektuar.

20. Asfaltoshtruese – 1 copë

Asfaltoshtruesja nevojitet për shpërndarjen uniforme të shtresave asfaltike në segmentet rrugore të prekura nga ndërtimi i rrjetit. Preventivi parashikon shtresa binderi dhe punime asfaltike, ndaj pajisja është drejtpërdrejt e lidhur me rikthimin e shtresave rrugore.

21. Autobitumatrice – 1 copë

Autobitumatricja nevojitet për aplikimin uniform të spërkatjes bituminoze ndërmjet shtresave rrugore, duke garantuar lidhjen e duhur ndërmjet shtresës bazë dhe shtresës asfaltike. Preventivi parashikon shprehimisht përdorimin e sprajit bituminoz.

22. Gjenerator / Motogjenerator – 1 copë

Gjeneratori nevojitet për sigurimin e energjisë elektrike në frontet e punës ku nuk ka furnizim të qëndrueshëm me energji, për përdorimin e pajisjeve të saldimit, pompave, veglave elektrike dhe pajisjeve të tjera të kantierit.

23. Elektrosaldatrice / Motosaldatrice / Saldatrice – 1 copë

Pajisja e saldimit nevojitet për realizimin e punimeve metalike, lidhjen dhe riparimin e elementëve prej çeliku, konstruksioneve metalike dhe aksesorëve që përdoren në strukturat dhe pajisjet e objektit.

24. Pajisje elektrofuzioni për saldimin e tubave PE – 2 copë

Pajisjet e elektrofuzionit janë të nevojshme për realizimin e lidhjeve të tubave dhe rakorderive prej polietileni nëpërmjet elektrofuzionit. Kërkesa për 2 pajisje lidhet me mundësinë e punës paralelisht në më shumë se një front të shtrirjes së tubacionit.

25. Pompë presioni dhe aparat digjital për testimin e presionit – 1 komplet

Kjo pajisje është e domosdoshme për kryerjen e provave hidraulike të tubacioneve pas montimit. Me anë të saj verifikohet qëndrueshmëria e rrjetit ndaj presionit, hermeticiteti i lidhjeve dhe mungesa e rrjedhjeve përpara vënies së sistemit në shfrytëzim.

26. Sistem Well Point për largimin e ujërave nëntokësore – 1 komplet

Sistemi Well Point nevojitet për uljen dhe kontrollin e nivelit të ujërave nëntokësore gjatë gërmimeve të kanaleve, pusetave dhe themeleve. Ai mundëson zhvillimin e punimeve në kushte të thata dhe të sigurta, shmang destabilizimin e faqeve të gërmimit dhe lehtëson montimin e tubacioneve dhe realizimin e strukturave betonarme.

27. Trencher për hapje kanali që montohet në eskavator – 1 copë

Trencher-i është pajisje e specializuar për hapjen e kanaleve me gjerësi të kontrolluar për vendosjen e tubacioneve. Përdorimi i tij rrit produktivitetin dhe saktësinë e gërmimit dhe redukton volumnin e panevojshëm të dheut të gërmuar, veçanërisht në segmentet lineare të rrjetit.

28. Aparaturë Butt Fusion për tubat PE – 2 copë

Pajisja Butt Fusion është e nevojshme për realizimin e saldimit ballor të tubave prej polietileni, duke garantuar lidhje homogjene dhe rezistente ndaj presionit. Pajisja me kontroll të parametrave të saldimit mundëson kontrollin e temperaturës, presionit dhe kohës së procesit. Dy pajisje lejojnë kryerjen paralelisht të punimeve në fronte të ndryshme.

29. Pajisje gjeodezike GPS – 1 copë

Pajisja GPS nevojitet për piketimin e gjurmës së tubacionit, përcaktimin dhe kontrollin e kuotave, pozicionimin e pusetave dhe strukturave, si dhe rilevimin e punimeve të realizuara. Punimet topogjeodezike janë pjesë e drejtpërdrejtë e objektit dhe përfshijnë matje, piketime dhe kontroll gjeometrik të elementëve të projektit.

30. Fabrikë Betoni e pajisur me lejen përkatëse mjedisore – 1 copë

Disponimi i një burimi të garantuar furnizimi me beton është i nevojshëm për sigurimin në kohë dhe me cilësinë e kërkuar të betonit që do të përdoret për depot e ujit, pusetat, themelet, muret dhe strukturat e tjera betonarme. Mundësia e disponimit në pronësi, me qira ose me kontratë furnizimi garanton vazhdimësinë e furnizimit gjatë zbatimit të kontratës.

31. Fabrikë Asfaltbetoni e pajisur me lejen përkatëse – 1 copë

Fabrika e asfaltobetonit nevojitet për garantimin e furnizimit me përzierje asfaltike për rikthimin e shtresave rrugore të dëmtuara nga hapja e kanaleve. Disponimi i saj nëpërmjet pronësisë, qirasë ose kontratës së furnizimit garanton furnizim të vazhdueshëm dhe në përputhje me kërkesat teknike të asfaltit.

32. Nyje prodhimi inertesh – 1 copë

Nyja e prodhimit të inerteve nevojitet për sigurimin e materialeve granulare, çakëllit, stabilizantit dhe materialeve të tjera që përdoren për shtresat mbushëse, nënbazat, bazat rrugore dhe prodhimin e betonit. Disponimi nëpërmjet pronësisë, qirasë ose kontratës së furnizimit garanton furnizimin në vazhdimësi me materialet e nevojshme gjatë realizimit të punimeve.

Argumentim përmbledhës

Kërkesa për disponimin e mjeteve dhe pajisjeve të mësipërme është përcaktuar në funksion të natyrës, volumit, kompleksitetit dhe shtrirjes së punimeve që parashikohen të realizohen për objektin “Ndërtimi i ujësjellësit Qeparo”. Mjetet dhe pajisjet janë të nevojshme për realizimin e proceseve kryesore të punës, si gërmimet dhe transporti i materialeve, hapja dhe përgatitja e kanaleve, montimi dhe saldimi i tubacioneve, realizimi dhe testimi i rrjetit të ujësjellësit, punimet e betonarmese, kontrolli dhe largimi i ujërave nëntokësore, mbushja dhe ngjeshja e kanaleve, rikthimi i shtresave rrugore, asfaltimi dhe kryerja e matjeve topogjeodezike.

Disponimi i tyre synon të sigurojë që operatori ekonomik të ketë kapacitetet teknike dhe organizative të nevojshme për realizimin e kontratës brenda afatit, sipas projektit, preventivit dhe specifikimeve teknike, si dhe për zhvillimin paralel të proceseve të ndryshme të punës.

2.3.8 Në përputhje me kërkesat dhe përmasat e publikuara nga Autoriteti Kontraktor në specifikimet teknike dhe preventiv, për listën e artikujve, si më poshtë:

- Tuba Ujësjellësi PE
- Tuba gizë modulare (DCI)
- Rakorderi për ujësjellës prej gizë dhe polietileni, sipas preventivit
- Pajisje për ujësjellës saracineska, matës uji, ajruer, hidrante, sita me flanaxhë prej çeliku inox, valvul galexhant (notuese), valvul reduktuese presioni, pjesë çmontuese, sipas preventivit.
- Njësi dozimi klori për dezinfektimin e ujit, sipas preventivit

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Autorizim të Prodhuesit / ve ose autorizim nga Distributori i autorizuar prej Prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave. Autorizimi / Marrëveshja e bashkëpunimit duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, website, e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij, si dhe të jetë e vlefshme deri në realizimin e plotë të punimeve. Në rast të disponimit të autorizimit të prodhuesit në gjuhë të huaj, ky dokument të paraqitet i përkthyer dhe i noterizuar në gjuhën zyrtare shqipe.
- Katalogun / et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit / ve për listën e mësipërme të artikujve në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen. Shënim: Fragmentet e Katalogut / ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përket.
- Operatori Ekonomik duhet të paraqesë certifikatë dhe/ose vetëdeklarim nga prodhuesi që sistemi i menaxhimit të cilësisë është sipas standardeve ISO 9001:2015 dhe ISO 14001:2015. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën e verifikimit të dokumentacionit të paraqitur gjatë procesit të vlerësimit.
- *OE të paraqesë një deklaratë, ku merr përsipër të garantojë instalimin si dhe servisin e pajisjeve gjatë periudhës së garancisë (2 vite), për defektet që vijnë nga prodhimi i tyre.*

Fleta ose fletët e katalogut që pasqyrojnë specifikimet teknike të kërkuara të pajisjeve/materialeve, duhet të paraqiten në gjuhën shqipe, të përkthyer dhe noterizuar.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 39, pika 8, si dhe në bazë të nenit 45, pika 1 të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Në preventivin e punimeve ka një numër të madh zërash që janë furnizim vendosje pajisje dhe nisur nga pesha specifike si në sasi dhe në vlerë që këto zëra zënë në preventive. AK e ka parë të domosdoshme kërkimin e autorizimit të prodhuesit për të garantuar cilësinë e pajisjeve për nga vetë rendesia që ka ky objekt. Kërkesa e këtij dokumenti që ne kete faze krijon nje lehtësi per Autoritetin Kontraktor pasi ne kete menyre siguron cilesine, specifikimet teknike te ketyre pajisjeve e cila eshte lehtesisht e kontrollueshe gjate fazes se zbatimit ne reference me dokumentat e paraqitura qe gjate kualifikimit. Nepermjet dorezimit te këtij dokumentacioni që ne fazen e vleresimit asnje OE ekonomik nuk i shmanget dot detyrimit që gjate zbatimit te furnizojë te njejtin mall te certifikuar nga KVO.

Kjo kërkesë është kërkuar që t’i sigurojë Autoritetit Kontraktor që operatori ekonomik ka kapacitetin e nevojshem teknik dhe ploteson specifikimet e kërkuara nga projektuesit për zbatimin në kohë dhe cilësi të kontratës për këtë objekt. Për të krijuar bindjen e autoritetit kontraktor për aftësitë teknike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur të operatorëve ekonomik fitues potencialë dhe realizimin me sukses të kontratave, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin autorizim nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/ distributor autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë pajisjet dhe mallrat e nevojshme në këtë procedurë prokurimi. Duke qenë se materialet e kërkuara prodhohen në mënyrë industriale, certifikimi nga prodhuesi mbi parametrat e tyre është i domosdoshëm.

Duke marrë shkas nga tipologjia e objektit të prokurimit dhe nga punimet/shërbimet që parashikohen të realizohen në preventive si dhe për shkak të interesit të lartë që ka objekti duhet të garantohet që mallrat kryesore të jenë sipas standarteve më të mira europiane, është gjykuar të domosdoshme të garantohet që mallrat kryesore të jenë sipas standarteve më të mira europiane, që OE ka aftësi të mjaftueshme për të realizuar me sukses dhe cilësi kontratën, duke furnizuar brenda kohës së përcaktuar vetëm pajisje origjinale me garanci, si dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për të bërë krahasueshmërinë e materialeve të ofruara nga operatori me ato të kërkuara në dokumentat e tenderit. Për të siguruar këtë gjë, por njëkohësisht dhe për të detyruar ofertuesit e mundshëm në zbatimin e këtyre standarteve ka parashikuar kërkesën e mësipërme, vetëm për disa nga mallrat kryesorë me që do të përdoren në këtë objekt dhe konkretisht OE duhet të japin dhe paraqesin në menyre te detajuar karakteristikat teknike të mallrave të përfshirë në dokumentat e tenderit, karakteristika këto që duhet të përputhen me specifikimet teknike të kërkuara nga projektuesi. Me anë të venies në dispozicion në fazen e ofertimit dokumentat si autorizim-marreveshje angazhimi, kataloge, ofertuesi garanton Autoritetin Kontraktor se mallrat që do të furnizojë do të jenë prodhim sipas kërkesave të projektit. Plotësimi i kërkesës me siper garanton Autoritetin Kontraktor për cilësinë dhe standartet e larta ndërkombëtare dhe të përditësuara sipas teknologjisë së re dhe bashkëkohore.

2.3.9 Operatori Ekonomik duhet të jetë i licensuar nga QKB me Kodin III.2.B - Grumbullim dhe transport i mbetjeve të Ngurta, së bashku me aktin e miratimit dhe kodet 17 01 , 17 01 01 , 17 01 07 , 17 05 04 , 17 05 06 , 17 05 08 , në përputhje me parashikimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të biznesit dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” i ndryshuar.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë licencat profesionale sipas zërave të preventivit që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit merr përsipër të realizojë.

Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe në nenin 4, pika e 1/b e ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, ku parashikohet se: “*leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/B të këtij ligji*”.

Në shtojcën 1/B është listuar edhe veprimtaria “Menaxhimi i mbetjeve”.

Në nenin 57/2 të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, parashikohet se: “*Qendra Kombëtare e Licencimit lëshon licencën për transportin e mbetjeve, e cila përfshihet në nënkategorinë III.2.B të fushës III të vendimit nr. 538, datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, pas miratimit të saj nga ministri*”.

Ndërkohë, sipas VKM nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (qkl) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”: “*Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme*”.

2.3.8 Operatori Ekonomik të ketë laborator testimi ose kontratë shërbimi materiale me një laborator testimi .

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për një laborator testimi të betonit, i cili duhet të jetë i akredituar nga organizma kombëtar ose ndërkombëtar është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 2 dhe 4.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

NJËSIA E HARTIMIT TË DOKUMENTAVE TË TENDERIT